



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 135/25 Dt. 20.02.2025



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja b dhe g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 12 të Rregullores MF –Nr-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet e Organizatave Jo Qeveritare (OJQ) në fushën e shërbimeve sociale në Komunën e Prizrenit, për vitin 2025.

1

- 1.1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF – Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
- 1.2. Mbështetja financiare publike për projektet e OJQ-ve do të ofrohen nga Buxheti i Komunës së Prizrenit, kodi ekonomik subvencione në shumën prej 100.000.00 € (njëqindmijë euro).

2

Mjetet e përmendura në pikën 1.2. të këtij Vendimi do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe dispozitave të Rregullores MF –Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

3

Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
  - Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Arkivës së Kryetarit.

